



BASHKIA DROPULL

RAPORTI I PERFORMANCËS

2019

DISCLAIMER

Raporti i performancës bazohet në të dhënat e konsoliduara të zbatimit të buxhetit për bashkinë Dropull gjatë vitit 2019 “**miratuar në Këshillin Bashkiak**”.

Ky dokument është prodhuar nga Bashkia Dropull me asistencën e Projektit Bashki të Forta dhe Smart Processes.

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

BASHKIA DROPULL



Bashkia Dropull ndodhet në Qarkun e Gjirokastrës dhe shtrihet në pjesën juglindore të vendit tonë. Kjo Bashki përbëhet nga 3 njësi administrative, të cilat janë: Dropull i Poshtëm, Dropull i Sipërm dhe Pogon. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e qarkut Gjirokastrë. Bashkia ka nën administrimin e saj 41 fshatra. Dropull i Poshtëm me 16 fshatra, Dropull i Sipërm me 18 fshatra dhe Pogoni me 7 fshatra. Sipas rregjistrimit të Gjendjes Civile, me datë 01.01.2019, Bashkia numeron 22685 banorë. Qendër bashkie, është fshati Jorgucat. Ai gjendet në pozicion gjeografik të përshtatshëm duke qënë në qendër të Dropullit, në degëzimin e rrugës

nacionale Gjirokastrë – Kakavi dhe Gjirokastrë – Sarandë. Ka luajtur rol si qendër administrative si gjatë periudhës së mbretërisë shqiptare ashtu edhe në vitet e para të pas luftës. Popullsia në bashkinë e Dropullit i përket minoritetit etnik grek. Kjo zonë është karakterizuar përherë nga emigracioni, theksuar kjo dukuri pas vitit 1997. Popullsia karakterizohet nga mosha e tretë, të rinjtë pergjithesisht janë të larguar në emigracion. Vitet e fundit, me krizën ekonomike që ka përfshirë më gjerë rajonin ka sjellë një rritje të ndjeshme në kultivimin e tokave bujqësore. Ngaqë emigracioni është i lidhur kryesisht me shtetin fqinj Greqinë, të emigruarit kthehen shpesh dhe për periudha kohe të konsiderueshme, sidomos në periudhat e festave dhe atë të verës. Kjo shton gjallërinë e zonës dhe zhvillimi i qëndrueshëm i saj mund të ndikojë në kthimin permanent qoftë edhe të një pjese të tyre. Bashkia e Dropullit ruan një pasuri të rrallë etno-kulturore. Zona ka ruajtur dhe transmetuar fillloksenine(mikpritjen), gjuhen, letersine dhe qyteterimin helen, vallet e bukura, polifonine, kostumet e pasura, motivet epirote të klarinetës, kishat dhe manastiret, sitet arkeologjike, arkitektonine karakteristike, punimet e gurit, artizanatin, zejet, perpunimin e produkteve bujqësore e blegtorale, gastronomine e nderlidhur me traditën etj.. Njësi administrative Dropull i Poshtëm ka fshatra me popullsi më të përqendruar krahasuar me dy njësitë e tjera. Kjo tregohet me raportin e popullsisë aktuale për njësi administrative dhe numrin e fshatrave që ka çdo njësi. Popullsia e bashkisë dominohet më shumë nga grupmosha 15-64 vjeç, e cila përbën 58.5% të popullsisë totale. Mosha e tretë (65 vjeç) zë përqindje të konsiderueshme, 33.8% të popullsisë. Ky është treguesi me vlerën më të lartë në vendin tonë. Ndërsa grupmosha 0-14 vjeç përbën vetëm 7.7% të popullsisë së bashkisë. Kjo strukturë grup-moshash shpjegohet me nivelet e larta të emigracionit të popullatës vendase drejt Greqisë. Pjesa më e madhe që emigron është ajo që i përket moshës 15-65 vjeç, pra forca aktive, vecanërisht emigrimi i të rinjve, duke lënë pas njerëz të moshuar. Bashkia Dropull shtrihet në një sipërfaqe prej 466.67 km² me një densitet prej 48.61 banorë/km². Dropullitet karakterizohen nga një interes i lartë për arsimin, kulturën, përparimin shoqëror në përgjithësi. Arsimi në Dropull arrin tregues shumë të ulët për numrin të nxënësve në rajon. Në territorin e bashkisë ka katër kopshte femijesh, prej të cilave një jopublik dhe dy shkolla të mesme të bashkuara, respektivisht në Dervician, Goranxi, Jergucat, Dervician dhe Bularat, Dervician ku mësojnë rreth 200 nxënës dhe femije. Banorët e Dropullit aksesojnë shërbime shëndetësore të specializuara në spitalin rajonal të Gjirokastrës. Në territorin e bashkisë ofrohet shërbim shëndetësor në tre qendra shëndetësore dhe njëmbëdhjetë qendra ambulatorie me pesë mjekë të përgjithshëm familje, të cilët janë të shpërndarë dy në Dropullin e Poshtëm, po kaq në Dropullin e Sipërm, dhe një në Pogon. Mbledhja, grumbullimi dhe trajtimi i mbetjeve në Dropull merr rëndësi të madhe në lidhje me sigurimin e një mjedisi të pastër. Kjo merr edhe më shumë rëndësi po të marrim në konsideratë se Dropulli është pjesë e aksit të rëndësishëm të fluksit më të madh të hyrjeve në vendin tonë nga pika e kalimit kufitar

të Kakavijës. Mbetjet e hedhura, nëpërmjet rrjetit fizik ujqor përfundojnë në lumin Drino dhe degëzimeve të tij. Ky lum përshkon pothuajse paralel dhe disa herë në distancë shumë të vogël rrugën nacionale Gjirokastër – Kakavi. Si pasojë, përveç të tjerave, kemi edhe ndotje estetike të mjedisit. Ky lum përshkon dhe pjesën e poshtme të qytetit të Gjirokastrës, duke ndikuar në shtrirjen e fenomenit të ndotjes edhe në të. Përfundimisht, i gjithë fluksi i mbetjeve të pakontrolluara të zonës më të gjerë (dhe jo vetëm të Dropullit), mbërrin në lumin Vjosë dhe që aty në detin Adriatik. Zonat e popullura urbane kanë nevojë më të madhe për këtë shërbim. Qendra e magazinimit të mbetjeve në rajonin e Delvinës, për shkak të afërsisë fizike, shihet si një mundësi e mirë për të përmirësuar shërbimin e pastrimit.. Megjithatë, ndryshe nga shumica e njësive vendore, shkalla e papunësisë për bashkinë mund të themi se paraqitet e ulët, 21.7% është indeksi i papunësisë për bashkinë, kur mesatarja për vendin e këtij treguesi është 29.3%. Indeksi i papunësisë për të rinjtë (mosha 15-24 vjeç) paraqitet i lartë , 31.1% ndërsa papunësi te femrat 20% . Për shkak të natyrës mikse të ekonomisë lokale, banorët janë të punësuar në sektorë të ndryshëm si bujqësi, industri dhe shërbime. Ka rreth 122 biznese të vogla dhe 54 biznese të mëdha dhe vetëm një përqindje e vogël e tyre drejtohen nga gratë, ndërkohë që ka një numër të konsiderueshëm të grave që janë të punësuar në pozicione të ndryshme drejtimi në sektorët e brendshëm të subjekteve apo edhe si punëtore. Struktura e punësimit në këto sektorë paraqitet si më poshtë: në bujqësi janë të punësuar 10.2% e forcës aktive të punës, në industri rreth 32.4%, dhe në shërbime 57.3%. Vihet në dukje se në territorin e Bashkisë Dropull funksionon një numër i konsiderueshëm biznesesh, disa prej të cilave me rëndësi jo vetëm rajonale, por edhe kombetare. Kjo ka sjellë që në këtë zonë të ketë një numër të konsiderueshëm fuqie punëtore të angazhuar prej bashkive fqinje.



ORIENTIM AFATGJATË

Fushat kryesore të orientimit afatgjatë të bashkisë Dropull janë: Rritja e askesueshmerise dhe integrimi territorial. Integrimi ne rajonin ekonomik nderkufitar permes zhvillimit dhe diversifikimit te ekonomise lokale. Ruajtja e karakterit rural te vendbanimeve dhe permiresimi i cilesise dhe kushteve te jeteses. Mbrojtja e pejzazhit, habitateve natyrore dhe mobilizimi ndaj emergjencave

TË DHËNA TË PËRGGJITHSHME 2019

PROFILI

Popullsia



3 njësi administrative

467 km²
sipërfaqe

BASHKIA DROPULL


Kryetari i Bashkisë




Dhimitraq Toli

Këshilli i Bashkisë

21 anëtar



12 Femra



9 Meshkuj

Nocione dhe mënyra e llogaritjes së disa treguesve të përdorur në këtë raport

- Të Ardhura Buxhetore prej Burimeve të veta tregojnë kapacitetin financiar të bashkisë dhe përfshijnë përveç taksave, tarifave, të ardhurave të tjera nga asetet dhe donacionet edhe të ardhurat e trashëguara nga një vit më parë.
- Të ardhurat nga QQ përfshijnë trasnfertat e pakushtëzuara të ministrisë së financave, transfertat e kushtëzuara për projekte të caktuara të ministrive të linjës dhe FZSHH si edhe transfertat të qeverisë qendrore për funksione të deleguara apo specifike.
- Programet buxhetore janë ato zëra të shpenzimeve të buxhetit të cilat financojnë funksionet ligjore të bashkisë të cilat janë funksione të veta ose funksione të deleguara nga qeveria qendrore.
- Treguesit kyc financiarë – llogaritja dhe domethënia e tyre

- **Norma e totalit të shpenzimeve ndaj totalit të të ardhurave** = Ky raport tregon shpenzimet si një përqindje kundrejt të ardhurave, me pak ndryshime – raporti tregon sesa shpenzon njësia për të ofruar një Lek shërbime publike
- **Norma e të ardhurave nga burimet e veta ndaj totalit të të ardhurave** = Tregon qëndrueshmërinë fiskale të njësisë. Kujtojmë që në këtë tregues nuk përfshihen të ardhurat e trashëguara nga viti kaluar. Një raport i lartë është pozitive për njësinë pasi tregon se njësia nuk mbështetet në burime të jashtme (si transfertat e qeverisë qendrore, grantet etj.)
- **Norma e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore ndaj totalit të të ardhurave** = tregon kaacitetin fiskal të bashkisë. Një normë e lartë mund të sygjerojë jo vetëm mbledhjen e mirë të detyrimeve fiskale por edhe taksa apo tarifa të larta.
- **Raporti i të ardhurave faktike nga taksat dhe tarifat vendore ndaj planit të tyre** = Një diferencë e madhe ose në rritje midis të ardhurave të arkëtuara dhe atyre të planifikuara përgjatë viteve mund të tregojë një rënie të përgjithshme të ekonomisë vendore. Nëse kjo diferencë bëhet e përheshme atëhere problem është mbledhja e taksave dhe tarifave
- **Norma e shpenzimeve për investime kapitale ndaj totalit të shpenzimeve** = Një normë e lartë tregon një menaxhim të mirë të financave vendore duke ofruar përmirësime në shërbimet vendore
- **Norma e shpenzimeve për personelin ndaj totalit të shpenzimeve** = Rritja e shpenzimeve për personelin mund të tregojë se shpenzimet po rriten më shumë sesa të ardhurat (pasi zakonisht kostot e personelit kanë pjesën më të madhe të shpenzimeve buxhetore të bashkisë).
- **Norma e huamarrjes afatgjatë ndaj totalit të të ardhurave** = huaja afatgjatë i referohet një periudhe më të madhe sesa një vit. Një raport / normë e ulët tregon se bashkia është e aftë ta paguajë borxhin (principal + interesin) sipas afatit të caktuar, një normë e lartë mund të sygjerojë se bashkisë do ti duhet të ulë ofrimin e shërbimeve për qytetarët në mënyrë që të shlyejë borxhin
- **Norma e detyrimeve të vonuara ndaj totalit të të ardhurave** = Detyrimet e vonuara janë pagesa që bashkia nuk ia ka bërë të tretëve brenda afateve ligjore (kontrata; fatura të papaguara etj). Një normë e lartë tregon mundësinë financiare të bashkisë nga të ardhurat e saj për të respektuar detyrimet kundrejt të tretëve.
- **Norma e shpenzimeve për politikave sociale ndaj totalit të shpenzimeve** = Një normë e lartë tregon ndërmarrjen e politikave të reja ose masa në fushën e shërbimeve sociale ose rritje të numrit të përfituesve të këtyre politikave/masave.



Përmirësim



E njëjta situatë



Përkeqësim



Nuk ka informacion

INFORMACION MBI SHPENZIMET

Realizim i shpenzimeve korrente

Shpenzimet korrente, përfshirë edhe shpenzime për paga dhe sigurimet shoqërore të punonjësve të bashkisë janë realizuar në vlerën 155,197 mijë lekë. Shpenzimet korrente kanë zënë 71.4% të shpenzimeve totale buxhetore dhe krahasuar me vitin 2018 pesha e shpenzimeve korrente në buxhet është ulur në masën -9%. Realizimi i shpenzimeve të personelit krahasuar me planin e vitit 2019 është në masën 86.2%. Shpenzimet korrente janë përqënduar kryesisht në Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi, Kujdesi social për familjet dhe fëmijët, Sherbime publike vendore, Mbrotja nga zjarri dhe mbrojtja civile.,

Realizim i shpenzimeve kapitale

Shpenzimet kapitale janë realizuar në vlerën 62,261.3 mijë lekë. Investimet kanë zënë 28.6% të shpenzimeve totale buxhetore dhe krahasuar me vitin 2018 pesha e investimeve në buxhet është rritur në masën 6.5%. Investimet janë përqënduar kryesisht në Menaxhimin e rrjetit rrugor, Furnizimi me ujë, Mbrotja nga zjarri dhe mbrojtja civile, Administrimi i pyjeve dhe kullotave


Në tabelën e mëposhtme paraqiten shpenzimet buxhetore sipas programe buxhetore të përdorura nga bashkia.

Fakt 2017	Buxheti i shpenzuar nga bashkia për secilin program buxhetor në vitin 2017
Fakt 2018	Buxheti i shpenzuar nga bashkia për secilin program buxhetor në vitin 2018
Plan 2019	Buxheti i planifikuar nga bashkia për secilin program buxhetor në buxhetin e vitit 2019
2019 vs 2018	Ndryshimi i buxhetit të shpenzuar nga bashkia në vitin 2019 kundrejt atij të shpenzuar në vitin 2018 në përqindje
Fakt 2019 vs Plan 2019	Përqindja faktike e realizimit të buxhetit kundrejt planit të vitit 2019

SHPENZIMET BUXHETORE

SHPENZIMET SIPAS PROGRAMEVE BUXHETORE TË PËRDORURA NGA BASHKIA						
1'000 LEK	FAKT 2017	FAKT 2018	PLAN 2019	FAKT 2019	2019 vs 2018	FAKT 2019 vs PLAN 2019
Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi	108,031	64,289	73,382	63,063	-1.9%	85.9%
Transporti publik	0	30,593	36,381	34,910	14.1%	96.0%
Kujdesi social për familjet dhe fëmijët	36,518	37,475	35,617	34,541	-7.8%	97.0%
Shërbime publike vendore	17,454	24,124	27,696	24,464	1.4%	88.3%
Furnizimi me ujë	54,747	37,200	25,005	22,775	-38.8%	91.1%
Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	0	8,722	17,183	14,366	64.7%	83.6%
Menaxhimi i Infrastruktues së ujitjes dhe kullimit	6,651	10,654	6,167	5,772	-45.8%	93.6%
Rrjeti rrugor rural	29,400	4,756	5,610	5,132	7.9%	91.5%
Administrimi i pyjeve dhe kullotave	1,198	3,668	7,325	4,380	19.4%	59.8%
Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	3,357	4,069	2,731	2,562	-37.0%	93.8%
Arsimi i mesëm i përgjithshëm	1,076	1,078	4,046	2,393	121.9%	59.1%
Gjendja civile	0	2,334	2,351	1,965	-15.8%	83.6%
Zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale	0	0	1,231	1,135		92.2%
Programe Vendore Zhvillimi	0	115,722	0	0	-100.0%	
Fondi i emergjencave dhe rezervave	0	0	2,250	0		0.0%
TOTALI	258,432	344,684	246,975	217,459	-36.9%	88.0%

ILUSTRIM PËR SHPENZIMET



FAKT 2019
vs
FAKT 2018



-36.9%

FAKT 2019
vs
PLAN 2019




-12.0%

BURIMET E FINANCIMIT

BURIMET						
1'000 LEK	FAKT 2017	FAKT 2018	PLAN 2019	FAKT 2019	2019 vs 2018	FAKT 2019 vs PLAN 2019
TË ARDHURA NGA BURIMET E VETA	51,093	47,176	48,942	50,991	8.1%	104.2%
Të ardhura nga taksat lokale	26,432	24,671	22,443	25,608	3.8%	114.1%
Të ardhura nga taksat e ndara	2,553	6,241	4,990	3,945	-36.8%	79.1%
Të ardhura nga tarifa vendore	21,943	15,010	20,949	20,883	39.1%	99.7%
Të ardhurat e tjera	165	1,254	560	555	-55.7%	99.1%
TË ARDHURA NGA BUXHETI QENDROR	230,184	261,135	169,622	169,622	-35.0%	100.0%
Transferta e pakushtëzuar	66,453	77,039	79,305	79,305	2.9%	100.0%
Transferta e kushtëzuar	148,230	153,197	58,911	58,911	-61.5%	100.0%
Trasferta specifike	15,501	30,899	31,406	31,406	1.6%	100.0%
HUAMARRJA	0	0	0	0	0	
Huamarrja afatshkurtë	0	0	0	0		
Huamarrja afatgjatë	0	0	0	0		
TRASHËGIMI NGA VITI I SHKUAR	27,673	42,670	26,362	26,362	-38.2%	100.0%
Trashëgimi pa destinacion	27,673	42,670	26,362	26,362	-38.2%	100.0%
Trashëgimi me destinacion	0	0	0	0		
TOTAL BURIME FINANCIARE	308,950	350,981	244,926	246,975	-29.6%	100.8%


BURIMET E FINANCIMIT NË VITIN 2019

ANALIZA E TE ARDHURAVE




- TË ARDHURA NGA BURIMET E VETA
- TË ARDHURA NGA BUXHETI QENDROR
- HUAMARRJA
- TRASHËGIMI NGA VITI I SHKUAR

TË ARDHURA NGA BURIMET E VETA




- Të ardhura nga taksat lokale
- Të ardhura nga taksat e ndara
- Të ardhura nga tarifa vendore
- Të ardhurat e tjera

TË ARDHURA NGA BUXHETI QENDROR




- Transferta e pakushtëzuar
- Transferta e kushtëzuar
- Trasferta specifike

TRASHËGIMI NGA VITI I SHKUAR



- Trashëgimi pa destinacion
- Trashëgimi me destinacion



NDRYSHIMI KUNDREJT VITIT PARARDHËS

↑ **8.1%** BURIMET E VETA TË FINANCIMIT

↓ **-35.0%** TË ARDHURA NGA BUXHETI QËNDROR

↓ **-38.2%** TRASHËGIMIA E VITIT TË SHKUAR

= TË ARDHURAT NGA HUAMARRJA

PESHA E SHPENZIMEVE BUXHETORE SIPAS PROGRAMEVE NË RAPORT ME TOTALIN E SHPENZIMEVE

PROGRAMET NË RAPORT			
Programe	Raporti kundrejt total 2017	Raporti kundrejt total 2018	Raporti kundrejt total 2019
Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi	41.8%	18.7%	29%
Transporti publik	0%	8.9%	16.1%
Kujdesi social për familjet dhe fëmijët	14.1%	10.9%	15.9%
Shërbime publike vendore	6.8%	7%	11.2%
Furnizimi me ujë	21.2%	10.8%	10.5%
Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	0%	2.5%	6.6%
Menaxhimi i Infrastruktues së ujitjes dhe kullimit	2.6%	3.1%	2.7%
Rrjeti rrugor rural	11.4%	1.4%	2.4%
Administrimi i pyjeve dhe kullotave	0.5%	1.1%	2%
Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	1.3%	1.2%	1.2%
Arsimi i mesëm i përgjithshëm	0.4%	0.3%	1.1%
Gjendja civile	0%	0.7%	0.9%
Zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale	0%	0%	0.5%
Programe Vendore Zhvillimi	0%	33.6%	0%
Fondi i emergjencave dhe rezervave	0%	0%	0%

PROGRAMET NË FOKUS TË BASHKISË

Planifikimi Menaxhimi
dhe Administrimi
29%



Transporti publik
16.1%




Kujdesi social për familjet
dhe fëmijët
15.9%



Shërbime publike vendore
11.2%



SHPENZIMET SIPAS KLASIFIKIMIT EKONOMIK



	2017	2018	2019
■ Shpenzime Korente	132,231	170,498	155,216
■ Shpenzime Kapitale	126,201	174,186	62,261
Total Shpenzime	258,432	344,684	217,459

TRENDI I INVESTIMEVE

ZBRITJE E INVESTIMEVE
GJATË VITIT 2019



RRITJE E INVESTIMEVE
NË VITIN
2018 KUNDREJT 2017



PROGRAMET MË TË MBËSHTETURA ME INVESTIME



Transporti publik
48.5 %



Furnizimi me ujë
36.6 %



Mbrojtja nga zjarri dhe
mbrojtja civile
3.8 %




Administrimi i pyjeve
dhe kullotave
3.6 %

PROJEKTET KRYESORE TË INVESTIMEVE TË REALIZUARA NGA BASHKIA

Projekti	Vlera e plotë e projektit	Viti i fillimit të projektit	Viti i përfundimit të projekti	Buxheti 2019	Plani i buxhetit viti 2019	REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i vitit deri në periudhën aktuale	% e Realizimit (nga fillimi deri në fund të vitit 2019)	Komente
Rik.rrugeve te brendshme te Bashkise	25,337	2019	2019	24,992	25,337	24,993	99%	
Ndërtim Ujesjellesi Manxifa	100,518	2016	2019	21,735	21,735	21,735	100%	
Financim i projekteve te B.E(TVSH)	4,010	2019	2019	4,010	4,010	4,010	100%	
Ndërtim depo uji	1,044	2018	2019	1,042	1,044	1,041	100%	
Rikonstruksion i rrugëve rurale	1,010	2019	2019	1,010	1,010	1,010	100%	
Iventar ekonomik	600	2019	2019	600	600	517	86%	
Blerje soba	120	2018	2019	120	120	120	100%	
Ndërtim ure Llongo,dervician,Dhuvian.	488	2018	2019	468	468	468	100%	
Monument kulture Dervician	80	2019	2019	0	80	0	00%	
Studim,projekt.Ura Llongo	700	2019	2019	420	700	420	60%	

PESHA E INVESTIMEVE SIPAS PROJEKTEVE KRYESORE NE VITIN 2019




TREGUESIT FINANCIAR


TREGUESIT

SITUATA FINANCIARE


Norma e totalit të shpenzimeve ndaj totalit të të ardhurave




Norma e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore ndaj totalit të të ardhurave




Norma e të ardhurave nga burimet e veta ndaj totalit të të ardhurave




Norma e shpenzimeve kapitale ndaj totalit të shpenzimeve




Norma e shpenzimeve korrente ndaj shpenzimeve totale




Normal e shpenzimeve të personelit ndaj totalit të shpenzimeve



Norma e detyrimeve të prapambetura ndaj totalit të të ardhurave



Norma e shpenzimeve në politikat sociale ndaj totalit të shpenzimeve



Bashkia ka financuar 14 programe buxhetore përkatëse të ndara në 6 funksione të saj ligjore:

Shërbimet e Përgjithshme Publike

01170-Gjendja civile

01110-Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi

Rendi dhe Siguria Publike

03280-Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile

Çeshtjet Ekonomike

04260-Administrimi i pyjeve dhe kullotave

04240-Menaxhimi i infrastruktuës së ujitjes dhe kullimit

04570-Transporti publik

04520-Rrjeti rrugor rural

Strehimi dhe Komoditetet e Komunitetit

06260-Shërbime publike vendore

06330-Furnizimi me ujë

Arsimi

09120-Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor

09230-Arsimi i mesëm i përgjithshëm

Mbrojtja Sociale

10430-Kujdesi social për familjet dhe fëmijët

Programe të Qeverisë Qendrore

01620-Zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale

06220-Programe Vendore Zhvillimi

04980-Fondi i emergjencave dhe rezervave

01 Shërbimet e Përgjithshme Publike

Programet buxhetore:



01110 Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi



01170 Gjendja civile

Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi



Ky program zë 29% të shpenzimeve totale të bashkisë

PËRSHKRIM PROGRAMI

Në këtë program buxhetor bashkia planifikon shpenzime buxhetore për zhvillimin dhe zbatimin e politikave të përgjithshme për personelin, shërbime të përgjithme publike, si: shërbimet e prokurimit, mbajtja dhe ruajtja e dokumenteve dhe arkivave të njësisë, ndërtesave në pronësi apo të zëna nga njësia, parqe qendrore automjetesh, zyra të printimit dhe IT etj., shpenzime për ofrimin e shërbimeve që mbështesin veprimtarinë e kryetarit, këshillit dhe komisioneve të këshillit, bazat e të dhënave vendore apo shërbime që lidhen me prodhimin dhe përhapjen e informacionit publik.

PËRSHKRIM REALIZIMI

Ne programin planifikim menaxhim,administrim (01110), kemi nje realizim te artikujve 600 601 ne masen 87.5 % , kjo per arsye te mos perdorimt te fondit te vecante te pagave (5%) dhe mosplotesimit 100% te struktures organike dhe numrit te punonjesve te miratuar nga Keshilli i Bashkise. Konkretisht struktura organike e vitit 2019 nuk u plotesua me tre pozicione drejtuese dhe dy pozicione nepunes egzekutiv. Po keshtu nuk jane realizuar shpenzimet per mallra dhe sherbime te tjera te ketij programi ne masen 3.803 mije leke ose 80 % per shkak te diferences se cmimeve ne prokurimet e mallrave dhe sherbimeve te domosdoshme per funksionimin e administrates vendore, si dhe mospageses se disa faturave te muajit Nendor-Dhjetor, per shkak te limitit nga ana e deges se thesarit.

01110-SHPENZIMET E PROGRAMIT

2019	Fakt 2017	Fakt 2018	Plan 2019	Fakt 2019	2019 vs 2018	Fakt 2019 vs Plan 2019
Korrente	49,389	59,645	72,682	62,535	4.8%	86.0%
Kapitale	58,642	4,644	700	528	-88.6%	75.4%
Total	108,031	64,289	73,382	63,063	-1.9%	85.9%

PRODUKTET E PROGRAMIT

	Fakt 2018	Plan 2019	Fakt 2019	Realizimi Faktik
Punonjës të trajnuar	16	32	28	87.5%
Ditë trajnimi në total		108	106	98.1%




QELLIMI I PROGRAMIT BUXHETOR

Qeverisje vendore e përgjegjëse dhe administrata e saj transparente

OBJEKTIVI I PROGRAMIT

Përmirësimi i menaxhimit të burimeve njerëzore

TREGUESIT E PERFORMANCËS

Matja e Treguesve të Performancës	Fakt 2018	Plan 2019	Fakt 2019	Trendi 2019 vs 2018	Realizimi Faktik
Rritja e qëndrueshmërisë së administrates civile(Numri i punonjësve që kanë qëndruar në punë kundrejt numrit total të punonjësve (raporti në % i qëndrueshmërisë))		91.7	76		83%
Rritja e kapacitetit të punonjësve të bashkisë(Raporti në % mes punonjësve të trajnuar dhe punonjësve total)	90%	100%	95%		95%
Rritja e kapaciteteve të punonjësve të bashkisë(Raporti mesatar i ditëve të trajnimit ndaj personave të trajnuar (ditë trajnimi/person))	3.5	4	3.8		95%

Gjendja civile



Ky program zë 0.9% të shpenzimeve totale të bashkisë

PËRSHKRIM PROGRAMI

Në këtë program buxhetor bashkia alokon fondet e pushtetit qendror për funksionin e deleguar të gjendjes civile në njësitë e vetëqeverisjes vendore

PËRSHKRIM REALIZIMI

Buxheti i programit 01170 "Gjendja civile" ka qenë planifikuar në masën 2,351 mijë lek dhe është realizuar 1,964 mijë lek, pra 83.54%. Në plan ky program ka planifikuar shpenzime për pagat, të cilat janë realizuar në masën 88.6%, shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore që janë realizuar në masën 75.95% dhe shpenzime operative të cilat nuk janë realizuar.

01170-SHPENZIMET E PROGRAMIT

2019	Fakt 2017	Fakt 2018	Plan 2019	Fakt 2019	2019 vs 2018	Fakt 2019 vs Plan 2019
Korrente	0	2,334	2,351	1,965	-15.8%	83.6%
Kapitale	0	0	0	0	0%	0%
Total	0	2,334	2,351	1,965	-15.8%	83.6%

PRODUKTET E PROGRAMIT

	Fakt 2018	Plan 2019	Fakt 2019	Realizimi Faktik
Numri i shërbimeve të ofruara nga gjendja civile në total	2,016	1,890	1,850	97.9%
Koha mesatare e përgjigjes ndaj kërkesave të qytetarëve (në ditë)	2	2	1.5	75.0%

QELIMI I PROGRAMIT BUXHETOR

Sigurimi i hedhjes, ruajtjes dhe ndryshimit të përbërësve të gjendjes civile të shtetasve shqiptarë, shtetasve të huaj dhe të personave pa shtetësi, me banim të përkohshëm/të përhershëm në R.SH.

OBJEKTIVI I PROGRAMIT

Shkurtimi i kohës në ofrimin e shërbimeve publike

TREGUESIT E PERFORMANCËS

Matja e Treguesve të Performancës	Fakt 2018	Plan 2019	Fakt 2019	Trendi 2019 vs 2018	Realizimi Faktik
Shkurtimi i kohës së përgjigjes ndaj kërkesave të qytetarëve(Koha mesatare e përgjigjes së kërkesave të qytetarëve (në ditë))	2	2	1.5		

03 Rendi dhe Siguria Publike



Programet buxhetore:



03280 Mbrotja nga zjarri dhe mbrotja civile

Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile



Ky program zë 6.6% të shpenzimeve totale të bashkisë

PËRSHKRIM PROGRAMI

Në këtë program buxhetor bashkia planifikon shpenzime buxhetore për të siguruar funksionimin e njësisve zjarrfikëse dhe shërbimeve të tjera të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit, shërbimet e mbrojtjes civile, si shpëtimet malore, vrojtimi i plazheve, evakuimi i zonave të përmytura etj, si dhe rritjen e kapaciteteve të punonjësve dhe ndërgjegjësimit në komunitet përmes programeve trajnuese të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit.

PËRSHKRIM REALIZIMI

Duke qene nje sherbim rëndesishem per bashkine tone, pasi menaxhojme nje teritor prej 467 km², ne pjesen me te madhe malor dhe pa infrastrukture te pershtatshme(rruge malore, breza antitermike, sistemime lumenjesh dhe perenjesh, etj), i kemi kushtuar rendesi te madhe strukturimit te plote dhe rritjes se efikasitetit dhe pritshmerise se tij. Gjate vitit 2019 realizuam nje total shpenzimesh prej 165% ne krahasim me te njejten periodhe te vitit te kaluar, por 84% ne krahasim me planin e vitit, ose 2.816 mije lek me pak, ku efektin me te madh e jep mosrealizimi i investimeve ne kte program (66%), pasi nuk eshte realizuar investimi per ndertim garazhi per mjetin zjarrfikes, pasi nga menaxhmendi u gjykua mbartja e tij per 2020, per tu plotesuar me nje studim-projektim me te kualifikuar e cilesor dhe zbatimit me nje ndertim me parametra plotesisht funksionale. Investimi qe u realizua gjate vitit 2019 ne kte program ishte blerja e nje mjeti te vogel e te shpejte, per nderhyrje ne raste shpetimi, por edhe zjarresh ne rruge te ngushta dhe zona te veshtira, dhe pajisja e tij mjetet baze. Kjo ka mundesuar nje reagim me te shpejte ne kohe reale per rastet e nderhyrjeve dhe ekonomizimin e shpenzimeve te nderhyrjeve duke rritur eficensen e sherbimit.

03280-SHPENZIMET E PROGRAMIT

2019	Fakt 2017	Fakt 2018	Plan 2019	Fakt 2019	2019 vs 2018	Fakt 2019 vs Plan 2019
Korrente	0	8,722	13,635	12,026	37.9%	88.2%
Kapitale	0	0	3,548	2,340		66.0%
Total	0	8,722	17,183	14,366	64.7%	83.6%

PRODUKTET E PROGRAMIT

	Fakt 2018	Plan 2019	Fakt 2019	Realizimi Faktik
Raste të menaxhuara për shuarjen e zjarrit dhe shpëtimit	49	60	63	105.0%
Numri i zjarrfikëseve	1	1	2	200.0%
Trajnime për fikjen e zjarrit dhe shpëtimit (ditë/vit)	4	5	6	120.0%
Koha e daljes nga stacioni në minuta	12	12	11	91.7%
Inspektime tek të tretët	16	15	15	100.0%



QELLI MI I PROGRAMIT BUXHETOR



Administrimi i parandalimit të zjarrit dhe problemeve të shërbimeve të mbrojtjes kundër zjarrit, permbytjeve dhe fatkeqësive natyrore dhe ndërhyrjeve për shpëtim

OBJEKTIVI I PROGRAMIT

Përmirësimi i shërbimeve të shuarjes së zjarrit dhe shpëtimit

TREGUESIT E PERFORMANCËS



Matja e Treguesve të Performancës	Fakt 2018	Plan 2019	Fakt 2019	Trendi 2019 vs 2018	Realizimi Faktik
Përmirësimi i shërbimit të parandalimit të rasteve të zjarrit (Numri i inspektimeve tek të tretët)	16	15	15		100%
Ulja e kohës së daljes nga stacioni pas raportimit (Dalja nga stacioni (ndryshimi në minuta kundrejt vitit të kaluar))		0	-1		

Rritja e kapaciteteve të punonjësve MZSH(Ditë trajnimi në vit)	4	5	6		120%
Përmirësimi i shërbimit ndaj komunitetit(Numri i rasteve të menaxhuara për shuarjen e zjarrit (ndryshimi vjetor në %))		22.5	28.6		127%

OBJEKTIVI I PROGRAMIT

Përmirësimi i kushteve dhe infrastrukturës në funksion të MZSH

TREGUESIT E PERFORMANCËS

Matja e Treguesve të Performancës	Fakt 2018	Plan 2019	Fakt 2019	Trendi 2019 vs 2018	Realizimi Faktik
Rritja e kapaciteteve të punonjësve zjarrfikës(Numri i trajnimeve për fikjen e zjarrit dhe shpëtimit (ditë/vit))	4	5	6		120%
Numri i makinave zjarrfikëse(Numri i makinave zjarrfikëse)	1	2	2		100%

04 Çeshtjet Ekonomike



Programet buxhetore:



04240 Menaxhimi i Infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit



04260 Administrimi i pyjeve dhe kullotave



04520 Rrjeti rrugor rural



04570 Transporti publik

Menaxhimi i Infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit



Ky program zë 2.7% të shpenzimeve totale të bashkisë

PËRSHKRIM PROGRAMI

Në këtë program buxhetor bashkia planifikon shpenzime buxhetore për ndërtimin ose organizimin e sistemeve të kontrollit të përmytjeve, sistemeve të ujitjes dhe kullimit, si dhe administrimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit. strimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit.

PËRSHKRIM REALIZIMI

